

UDHËZIM PËR VLERËSIM

VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.

DETYRA 1: Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë: P, S, P, P, S.

DETYRA 2: nxënësi merr **1 pikë** nëse e ka përkthyer ose perifrashuar fjalinë: Periudha e rrotullimit të Hënës rreth boshtit të saj zgjat aq sa orbita e saj rreth Tokës, në mënyrë që e njëjta anë e Hënës të jetë gjithmonë e dukshme nga Toka. / Periudha e rrotullimit të Hënës rreth boshtit të saj zgjat aq sa orbita e saj rreth Tokës.

DETYRA 3: është rrethuar numri 3 – sepse ka një gravitacion të dobët
1 pikë

DETYRA 4: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar JO dhe ka shkruar se për Hënën në tekst flitet nga aspekti shkencor flitet./Në te ka të dhëna shkencore, d.m.th. fakte/jepen faktet në të cilat bazohen njohuritë shkencore

Vërejtje:

1. Nxënësi merr 1 pikë nëse argumenton saktë, por nuk ka rrethuar as PO dhe as JO.
2. Nxënësi merr 0 pikë nëse ka rrethuar PO, pa marr parasysh saktësinë e argumentimit.

DETYRA 5: është rrethuar numri 2 – pika në të cilën Hëna është më e largët nga Dielli

1 pikë

DETYRA 6: nxënësi merr **2 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë: Pranohet nëse nxënësi udhëpërshkrimin e vendos në llojin gazetaresk.

Lloji letrar - artistik	Lloji kalimtar shkencor - letrar	Lloji gazetaresk
romani	biografia	raporti
kënga	udhëpërshkrimi	komenti
fabula	ditari	lajmi
poezia refleksive		

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2021-2022

Nxënësi merr 1 pikë për 8 ose 9 përgjigje të sakta.
Nxënësi merr 0 pikë për 7 ose më pak përgjigje të sakta.

DETYRA 7: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Dritëro Agolli

DETYRA 8: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: poeti (subjekti lirik)

DETYRA 9: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Kujdes me fjalën (*dhe përgjigje të tjera të sakta*)

DETYRA 10: është rrethuar numri 1 – alternuar
1 pikë

DETYRA 11: gjithsej **3 pikë:**

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Fuqia e fjalës (*dhe përgjigje të tjera të sakta*)
- B) nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar: Në dy strofat e para poeti shpreh fuqinë që ka fjala për të bërë mirë dhe keq. (*dhe përgjigje të tjera të sakta*)

Nxënësi merr 1 pikë nëse jep përgjigje më thjeshtë.

DETYRA 12: gjithsej **2 pikë:**

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Strofa katërvargëshe apo katreni
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Strofa trivargëshe apo terceti

DETYRA 13: gjithsej **2 pikë:**

narracioni/rrëfimi/përshkrimi (**1 pikë**)
dialogu (**1 pikë**)

DETYRA 14: nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. personifikimi - *Ç'ke flamur që s'valon?/Jam sëmurë e po rënkuj...*
2. krahasimi - *E ka qerpikun si krahu i dallëndyshes.*
3. antiteza - *Se të qante kur të qeshnin.*

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2021-2022

4. hiperbola - *Muji ngriti mbi shpatullat e tij shkëmbin.*

Nxënësi merr 1 pikë për 3 përgjigje të sakta.

Nxënësi merr 0 pikë për 2 ose më pak përgjigje të sakta.

DETYRA 15: nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. *Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e zotit* – Mitrush Kuteli
2. *Yjtë e zemrës* – Lasgush Poradeci
3. *Kulla* – Anton Pashku

Nxënësi merr 1 pikë për 2 përgjigje të sakta.

Nxënësi merr 0 pikë për 1 ose për asnjë përgjigje të saktë.

DETYRA 16: gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr nga 1 pikë nëse ka nënvizuar fjalën:

- A) *aviacioni (1 pikë)*
- B) *shpërbëj (1 pikë)*

DETYRA 17: gjithsej **3 pikë**

A) nxënësi merr *2 pikë për përgjigje plotësisht të saktë:*

- Artës* – rasa dhanore
- Ulqinit* – rasa gjinore
- Shëtitja* – rasa emërore

Nxënësi merr 1 pikë për 2 përgjigje të sakta.

Nxënësi merr 0 pikë për 1 ose për asnjë përgjigje të saktë.

B) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka shkruar: *Këto ditë u kryen punimet e tharjes së kënetës në fushën e Luginës.*

DETYRA 18: gjithsej **2 pikë**

- A) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka shkruar: *Kur pushimet mbaronin*
- B) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka shkruar: *fjali kohore*

DETYRA 19: gjithsej **3 pikë:**

- A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 4 - shpupurish

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2021-2022

B) Nxënësi merr 2 pikë për përgjigje plotësisht të saktë:

shtrembëroj
dalldis
zdrukthëtari

Nxënësi merr 1 pikë për 2 përgjigje të sakta.

Nxënësi merr 0 pikë për 1 ose për asnjë përgjigje të saktë.

DETYRA 20: Skema e vlerësimit të hartimit ***Sporti im i preferuar***

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan disa lloje të sportit (ekipore, individuale, ose edhe një të tjetër).

Gjithsej 1 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan për përparësinë/përparësitë e ushtrimit të sportit.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 3.

Nxënësi merr 1 pikë nëse e përshkruan shkurt sportin e tij të preferuar.

Për një përshkrim më të plotë merr 2 pikë.

Nëse bën një përshkrim më të plotë dhe me stil, merr 3 pikë.

Gjithsej 3 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi merr 1 pikë nëse përshkruan shkurt ndjenjat e veta/ndjenjat gjatë shikimit ose ushtrimit të sportit.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2021-2022

Për një përshkrim më të plotë merr 2 pikë.

Nëse bën një përshkrim më të plotë dhe me stil, merr 3 pikë.

Gjithsej 3 pikë

Kërkesa 5.

Nxënësi merr 1 pikë nëse jep ndonjë propozim se si të motivohen të rinjtë të merren me sport.

Gjithsej 1 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur 2 pikë	<u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës) 2 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u> → respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e	→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij 1 pikë → s' është i lidhur në nivel të tekstit dhe pjesëve të tij 0 pikë	→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike 1 pikë
→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, leksiku i varfër dhe përsëritja e shprehjeve pjesërisht e			

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2021-2022

<p>saktë</p> <p>1 pikë</p>	<p>fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p> <p><u>GRAMATIKA</u></p> <p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë</p> <p><u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>		
--	--	--	--